



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 47/09

Prishtinë, më 1.04.2009, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Haki Shatri, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Müfera Şinik, Besa Gaxherri, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Naser Osmani.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: **Argjentina Grazhdani Kryetare e Këshillit të KPM-së, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 18 mars 2009;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2008
Të ftuar: Përfaqësuesit e Bordit të KPM- së;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesës-propozimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nr. 03/1861 Do-1134, dt.18.03.2009 për emërimin e anëtarit jo-ekzekutiv të Bordit Drejtues të BQK-së, me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-084, dt. 23 mars 2009;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e Republikës së Kosovës nr. 03/L-132 me raportin e komisionit funksional -Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për zonat ekonomike nr.03/L- 129 me raportin komisionit funksional - Komisioni për Ekonomi, Industri, Tregti, Energjetikë dhe Telekomunikacion, me amendamente;**
- 7. Të ndryshme.**

Kryesuesi, arsyetoi mungesën e znj. Kosara Nikolić dhe znj. Safete Hadërgjonaj dhe më pas hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 18 mars 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 18 mars 2009, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës – propozimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nr. 03/1861 Do-1134, dt.18.03.2009 për emërimin e anëtarit jo-ekzekutiv të Bordit Drejtues të BQK-së, me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr.03-P-084, dt. 23 mars 2009

Kryesuesi, theksoi se materialin e kemi marrë me kohë. Për sqarime më të shumta rreth raportit, ia dha fjalën përfaqësueses së KPM-së.

Argjentina Grazhdani, shpjegoi pasqyrat financiare në bazë të të dhënave të prezantuara në këtë raport. Në bazë të kësaj, buxheti i KPM i vitit 2008 është realizuar 93,3 % (557.606 €). Megjithëse kërkesa buxhetore e lejuar nga MEF ka qenë 95 %, si rezultat i së cilës janë paraqitur probleme në pagesën e anëtarëve të Këshillit. Pagesat bëhen në bazë të një udhëzimi administrativ të Qeverisë për të cilin kemi paqartësi.

Naser Osmani, duke komentuar raportin pyeti si trajtohen televizionet e huaja që operojnë në Kosovë, a paguajnë taksa për licencë. Po ashtu z. Osmani u interesua se qfarë ka ndërmarrë KPM-ja lidhur me televizionet që veprojnë ilegalisht, psh. televizionet në gjuhën serbe.

Haki Shatri, theksoi se nuk ka vërejtje lidhur me pjesën financiare të raportit, shpenzimet janë realizuar ashtu siç janë planifikuar. Megjithatë shifet se shpenzimet komunale janë harxhuar vetëm 50 %, pyeti pse nuk janë shpenzuar brenda afatit vjetor.

Riza Smaka, konsideroi raportin të pranueshëm. Kërkoj disa sqarime rreth funksionimit të divizionit ligjor, sa punëtor ka, si janë të organizuar. Ndërsa duke komentuar pjesën shkeljeje të ligjit, theksoi se ka më shumë raste se sa janë paraqitur në raport. Janë identifikuar rastet por nuk kemi shqiptim sanksioneve. Në këtë drejtim pyeti rreth rrjedhjes së procedurës me rastin e atakimit të vendimit për shqiptimin e ndonjë sanksioni.

Myrvete Pantina, vlerësoi raportin gjithëpërfshirës. Megjithatë kërkoj disa sqarime. Në raport të hyrat nga taksat janë paraqitur afër 57.000 €, ndërsa në materialin shpjegues thuhet se nuk ka të hyra vetanake. Pyeti a konsiderohen të hyra vetanake të hyrat nga taksat. Theksoi se do të ishte mirë të zërtheheshin shpenzimet e ashtuquajtura “pajsje tjera” të paraqitura të kategoria mallra dhe shërbime, sepse kemi të bëjmë me shumat jo edhe aq të vogla të shpenzuara.

Hajdin Abazi, vlerësoi raportin si më të kompletuar se ai i vitit paraprak. Kërkoj sqarime për dy raste. Rasti parë kishte të bënte me “TV Herc” e cila ka licencë për të vepruar si program multietnik dhe multikulturor, ndërsa nga informacionet që ka ai, ky televizion nuk realizon këtë politikë redaktuese multikulturore, sepse në emisionet e tyre nuk janë ftuar të marrin pjesë asnjëherë zyrtarët komunal shqiptar. Çështje tjetër që interesoi ishte rasti i Radios “Zëri Sharrit” ndaj të cilët janë konfiskuar mjetet dhe ky rast nuk është prezantuar në raport. Në këtë drejtim z. Abazi kërkoj që

KPM-ja të ketë trajtim të njëjtë për të gjitha televizionet dhe radiot me rastin e shqiptimit të masave dhe jo vetëm ndaj atyre shqiptare. Përveç kësaj z. Abazi bëri vërejtje edhe për përmbajtjen e disa emisioneve që transmeton RTK-ja, që cenonë statusin e mediumit publik që ka.

Xhevdet Neziraj, vlerësoi raportin më të mirë se ai i vitit paraprak. Vërejtjet e tij janë më të shumta sa i përket politikës auditoriale, ndërsa në pjesën financiare përkrah atë.

Kryesuesi, duke pasur parasysh faktin se transmetuesit i raportojnë KPM-së, pyeti si i trajtoni ju këto raporte. Në këtë kontekst kërkoi një mendim se sa është vlerësuar shuma e tregut nga reklamat.

Argjentina Grazhdani, duke i përgjigjur pyetjes së z. Shatri lidhur me shpenzimet komunale, arsyeja pse ato janë shpenzuar 50% për shkak se për këtë pozicion buxhetor nuk janë aprovuar mjetet nga MEF-i ashtu siç janë kërkuar. Në pyetjen e z.Osmani, theksoi se KPM-ja nuk rregullon frekuencat satelitore, ajo administron vetëm ato kanale ndaj të cilave lëshohet licenca. Televizionet njëkohësisht regjistrohen edhe si biznese dhe ndaj tyre Ministria përkatëse duhet caktoj taksa. Në pyetjen për funksionimin e divizionit ligjor, ka mbetur që nga periudha e kaluar ndërsa jemi në proces të riorganizimit të strukturës organizative. Sa i përket pyetjes për të hyrat vetanake është bërë një lëshim dhe ato nuk janë përfshirë në raport, ndërsa mjetet e inkasuara nga licencat derdhen në buxhetin e Kosovës. Për përshkrimin “ paisje tjera” ekziston shpjegimi se për qfarë janë shpenzuar ato mjete dhe sipas interesimit mund t’iu dërgohen. Lidhur me rastin e Radios “Zëri të Sharrit”, arsyeja e marrjes së licencës dhe konfiskimit të mjeteve për shkak se nuk ka respektuar kushtet ligjore të licencës, ndërsa “TV Hercit” është ndër të parët që ka paguar licencën dhe ne nuk jemi kompetent të kontrollojmë politikën redaktuese. RTK dërgon raportin financiar dhe si të tillë ne e paraqesim në raport. Obligimi ynë në raport me RTK është të kujdesemi emetimin e reklamave dhe minutazhën e tyre dhe në këtë drejtim jemi në proces të nxjerrjes së një rregulloreje. Në pyetjen e kryesuesit për vlerën e tregut nga reklamat, sipas parashikimeve jo të vërtetuara theksoi se ato sillen rreth 5-6 milion €.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Duke u bazuar në analizën që i është bërë Raportit të KPM-së për vitin 2008, Komisioni për Buxhet dhe Financa konstatoi se i njëjti i plotëson standardet e raportimit financiar, dhe Kryesisë së Kuvendit i rekomandon që ta vendosë në rendin e ditës për shqyrtim në mbledhjen plenare.
4. **Shqyrtimi i kërkesës–propozimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nr. 03/1861 Do-1134, dt.18.03.2009 për emërimin e anëtarit jo–ekzekutiv të Bordit Drejtues të BQK-së, me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr.03-P-084, dt. 23 mars 2009**

Kryesuesi, theksoi se kërkesa për emërimin e anëtarit jo-ekzekutiv në bordin drejtues të BQK-së është procedura konform ligjit, është hapur konkursi publik, paneli intervistues ka nominuar anëtarin, prandaj kërkoi nga anëtarët të deklarohen për këtë propozim.

Riza Smaka, përkrahu anëtarin e propozuar duke e konsideruar person adekuat dhe profesional për atë pozitë.

Haki Shatri, gjithashtu përkrahu kandidatin e nominuar. Por megjithatë theksoi se nga propozimi nuk është treguar se a kanë marrë pjesë më shumë se dy kandidatë ashtu siç kërkohet me ligj për të qenë i vlefshëm konkursi. Prandaj propozoi që komisioni të kërkoj nga bordi i BQK-së të dërgoj

informacione shtesë që dëshmojnë pjesëmarrjen në konkurs të dy apo më shumë aplikantëve dhe pastaj t'i rekomandohet Kuvendit përkrahja e kandidatit të nominuar.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, dy Abstenime (Znj. Besa Gaxherri dhe Z. Xhevdet Neziraj) dhe asnjë Kundër, nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Përkrahet propozimi për emërimin e kandidatit, z. Mejdi Bektashi, për anëtar joekzekutiv në Bordin Drejtues të BQRK-së.
 - II. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që propozimin për emërimin e anëtarit joekzekutiv në Bordin Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ta vendosë në rendin e ditës në seancën plenare.
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës nr. 03/L-132 me raportin e komisionit funksional -Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente**

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës nr. 03/L-132 dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
 - II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Jashtme, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për zonat ekonomike nr. 03/L- 129 me raportin komisionit funksional - Komisioni për Ekonomi, Industri, Tregti, Energjetikë dhe Telekomunikacion, me amendamente**

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjit për zonat ekonomike nr. 03/L- 129 dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Industri, Tregti, Energjetikë dhe Telekomunikacion,

dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI